



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.38/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Hajriz Hoti kryesues, Kujtim Pasuli dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovë (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 17.01.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet i palejuar ankesa e parashtruar nga Instituti Demokratik i Kosovë (KDI), me seli në Prishtinë, A.nr.38/2021, e datës 15.01.2025, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datë 15.01.2025, PZAP-i ka pranuar një ankesë të parashtruar nga Instituti Demokratik i Kosovë (KDI), në të cilën pretendohet se Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me datë 13 Janar 2025, ka mbajtur tubim elektorale në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë si dhe Rregullores Zgjedhore nr. 07/ 2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, konkretisht neni 36, paragrafët 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, si dhe neni 4 paragrafit 1 të Rregullores Zgjedhore nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, rrjedhimisht ka cenuar rëndë dispozitat përkatëse ligjore duke shfrytëzuar institucionet e Arsimit, përkatësisht Kampusin e Shkollave të Mesme në Viti, për tubime publike zgjedhore dhe duke takuar dhe shfrytëzuar punëtorët e institucionit përkatës. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës disa fotografi si prove, që i referohen rrjetit social facebookut të kandidatit për kryeministër nga subjekti politik LDK.

Paneli pasi qe shqyrtoj lejueshmërinë e apelit gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesa e parashtruar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), ka njëjtësi objektive, gjendje të njëjtë faktike me ankesën e parashtruar nga Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje-LVV, Anr.34/2025 të paraqitur me datën 14.01.2025, kundër Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e cila çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr. 34/2025 të datës 16.01.2025 me të cilin Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i është shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej 6,000.00(gjashtëmijë) euro.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr. 34/2025 të datës 16.01.2025, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë.

Prandaj, nisur nga të gjitha arsyet e paraqitura lart, në pajtim me nenin 119 paragrafi 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke i hedhur poshtë ankesën si të pa lejuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 38/2025 më datën 17.01.2025

**Kryesues i Panelit
Hajriz Hoti**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.

